



OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

**METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR SHFRYTËZIMIN E
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES**

Maj 2013

Përmbajtja

Kapitulli I.....	3
1 Hyrje.....	3
1.1 Qëllimi.....	3
1.2 Fushëveprimi	3
1.3 Kërkesat Ligjore.....	3
1.4 Deklarata mbi parimet e ngarkesave të Shpërndarjes	3
1.5 Përkufizimet.....	3
Kapitulli II	5
2 Detaje mbi kërkesat ligjore	5
2.1 Referencat dhe ligji i zbatueshëm.....	5
2.2 Ligji për energjinë Nr. 03/L-184.....	5
2.3 Ligji për energjinë elektrike 03/L-201	6
2.4 Ligji për Rregullatorin e Energjisë 03/L-185.....	6
2.5 Rregulla për vendosjen e çmimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes(Rregulla për vendosjen e çmimeve OSSH-së).....	6
Kapitulli III.....	7
3 Vlerat Hyrëse	7
3.1 Balanca e Energjisë.....	7
3.2 Periudha Rregullative	7
3.3 Të hyrat e lejuara maksimale	7
3.4 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.....	8
3.5 Zhvlerësimi i lejuar.....	8
3.6 Kthimi i lejuar	8
3.7 Kostot e Lejuara të Humbjeve.....	8
3.8 Ngarkesa për Licence	8
Kapitulli IV.....	9
4 Alokimi i kostove	9
4.1 Faktorët e alokimit	9
4.1.1 Faktori i alokimit për fuqi.....	9
4.1.2 Faktori i alokimit për energji.....	10
4.2 Kostoja e humbjeve dhe alokimi i tyre.....	11
4.2.1 Humbjet teknike.....	11
4.2.2 Humbjet komerciale	14
Kapitulli V	16
5 Dizajnimi i Ngarkesave	16
5.1 Parimet	16
5.2 Struktura e ngarkesave.....	16
Kapitulli VI.....	17
6.1 Procedura për Aprovimin e Ngarkesave të OSSH-së.....	17
6.2 Dispozitat Përfundimtare	17

Kapitulli I

1 Hyrje

1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i ngarkesave me anë të cilave do të mbulohen të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së nëpërmjet ngarkesave për periudhën e caktuar rregullative. Ato përfshijnë Kostot e Kapitalit (në formën e zhvlerësimit dhe kthimit), Mirëmbajtjen, Operimin dhe Kostot e humbjeve të OSSH-së në mënyrë që të përmbushen kërkesat e konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit të mesëm dhe të ulët. Ngarkesat për Kyçje në sistemin e shpërndarjes do të mbulohen përmes Metodologjisë së Ngarkesave për Kyçje në Shpërndarje, të nxjerrë nga OSSH-ja dhe të miratuara nga ZRRE-ja.

1.2 Fushëveprimi

Kjo metodologji mbulon:

- a) Kornizën ligjore dhe rregullative për ngarkesat e sistemit për shfrytëzim të rrjetit të shpërndarjes;
- b) Përkufizimin e kushteve të Shfrytëzimit të Sistemit nga Rrjeti i Shpërndarjes(DUOS);
- c) Alokimin e kostove ;
- d) Dizajni i ngarkesave (ngarkesave).

1.3 Kërkesat Ligjore

Kjo Metodologji merr parasysh dhe u përmbahet kërkesave të parashtruara në:

- a) Ligjin për energjinë Nr 03/L-184
- b) Ligjin për energjinë elektrike Nr. 03/L-201;
- c) Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- d) Rregullën për vendosje të çmimeve për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për vendosje të çmimeve të OSSH-së).
- e) Parimet e përcaktimit të ngarkesave për shpërndarje

1.4 Deklarata mbi parimet e ngarkesave të Shpërndarjes

Neni 15 i Rregullës për Vendosjen e Çmimeve kërkon nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatitjen e kësaj Metodologjie të Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, në pajtueshmëri me Deklaratën e Parimeve të Ngarkesave të Shpërndarjes, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

1.5 Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet që nuk janë shënuar në vijim mund të gjenden në ligje, Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe në Metodologjinë e Ngarkesave të Sektorit të Energjisë Elektrike apo në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike.



“Operatori i sistemit të shpërndarjes” ose “OSSH” nënkupton autoritetin juridik që është pronar i sistemit të shpërndarjes në Kosovë dhe që është bartës i licencës për operator të sistemit të shpërndarjes;

“Shërbimet e sistemit të shpërndarjes” nënkupton shërbimet të cilat i licencuari për OSSH është i autorizuar t’i ofrojë sipas kushteve të licencës për operim të sistemit dhe për shpërndarje, të dhënë nga rregullatori, e që kanë të bëjnë me ofrimin e një sistemi të shpërndarjes të besueshëm, të qëndrueshëm dhe të sigurt për të gjithë personat që dëshirojnë ta përdorin sistemin;

“Shfrytëzim i sistemit” nënkupton shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për shpërndarje të energjisë elektrike nga pika hyrëse deri në pikat e furnizimit për konsumatorët kosovarë;

“Ngarkesa për shfrytëzimin e sistemit të OSSH-së” nënkupton ngarkesat e aplikuar nga OSSH për shfrytëzimin e sistemit;

“Kërkesa maksimale e sistemit të shpërndarjes” nënkupton kërkesën maksimale të energjisë elektrike brenda një viti (në MW) të matur në pikat hyrëse të sistemit të shpërndarjes të OSSH-së;

“E matur” nënkupton çdo sasi të matur të energjisë elektrike, duke përfshirë këtu matjet për energjinë aktive, energjinë reaktive dhe fuqinë, në pajtim me matësin e instaluar sipas Kodit të matjes;-

“Humbjet në shpërndarje” nënkuptojnë totalin e energjisë së humbur në sistemin e shpërndarjes të operuar nga OSSH dhe përbëhen nga (1) humbjet teknike siç përcaktohen nga vlerësimet inxhinierike, dhe (2) humbjet komerciale, të cilat përfshijnë energjinë në hyrje të sistemit të shpërndarjes minus humbjet teknike dhe minus energjia e faturuar te konsumatorët;

Kapitulli II

2 Detaje mbi kërkesat ligjore

2.1 Referencat dhe ligji i zbatueshëm

Në vijim janë paraqitur referencat ndaj neneve të ligjeve, rregullave, kodeve dhe metodologjive relevante. Në rast të mospërputhjes mes dispozitave ligjore dhe interpretimeve të dhëna në këtë metodologji, të zbatueshme do të jenë dispozitat përkatëse ligjore.

2.2 Ligji për energjinë Nr. 03/L-184

Ligji për energjinë përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme në bazë të të cilave zhvillohen aktivitetet në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të sigurimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe tejet cilësor të energjisë. Gjithashtu ofron kushte për funksionimin e tregjeve të energjisë dhe për promovimin e shfrytëzimit efikas të energjisë, shtimin e shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme dhe bashkëgjenerimit dhe për përmirësimin e mbrojtjes mjedisore gjatë veprimtarive energjetike.

Paragrafi 1 i Nenit 16 - Llojet e aktiviteteve të rregulluara, që bën pjesë në Kreun V – Rregullimi ekonomik i aktiviteteve energjetike, rregullon se aktivitetet energjetike duhet të realizohen në bazë të rregullave të cilat përcaktojnë se ato duhet të jenë konkurruese, (të bazuara në treg,) apo nëse janë aktivitete jonkonkurruese ngarkesat dhe kushtet tjera përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në pajtueshmëri me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Paragrafi 3 i lejon ZRRE-së imponimin e disa obligimeve të caktuara për shërbim publik për ndërmarrjet energjetike, e të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit të energjisë, rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit, dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto obligime duhet të jenë qartë të përcaktuara, transparente, jodiskriminuese dhe të vërtetueshme dhe duhet të garantojnë barazi në qasje për ndërmarrjet energjetike të vendeve që janë palë nënshkruese të Komunitetit të Energjisë.

Paragrafi 4 lejon që kostot dhe shpenzimet e hasura nga ndërmarrjet energjetike në lidhje me paragrafin 3, me kusht të shqyrtimit nga ZRRE për të siguruar arsyeshmërinë e tyre, të njihen si kosto të arsyetueshme dhe si shpenzime që përfshihen në kalkulimet tarifore. Kompensimi për këto kosto nuk guxon të tejkalojë kostot e hasura gjatë kryerjes së obligimeve për shërbime publike minus të hyrat e fituara nga ofrimi i shërbimit. Kompensimi mund të përfshijë edhe një profit të arsyeshëm.

Neni 17 – Rregullimi i ngarkesave të sektorit të energjisë, pjesë e Kreut V, kërkon, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, që të gjitha ngarkesat e rregulluara dhe metodologjitë tarifore tu ofrojnë ndërmarrjeve të rregulluara energjetike mundësi për të vënë ngarkesa dhe për të mbuluar tërë koston e arsyeshme vjetore të shërbimeve të ofruara.

2.3 **Ligji për energjinë elektrike 03/L-201**

Ligji për energjinë elektrike përcakton kushtet për realizimin e gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike, organizimin e rrjeteve dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Paragrafi 1.14 i Nenit 16 – Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, pjesë e Kreut V, i jep OSSH-së përgjegjësi për zhvillimin dhe propozimin e ngarkesave dhe metodologjive të ngarkesave për shfrytëzim dhe kyçje në sistemin e shpërndarjes në mënyrë jodiskriminuese dhe që ofron sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit, propozimet e tilla t'i parashtrohen ZRRE-së për miratim dhe publikim në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e dhëna në kreun IX të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

2.4 **Ligji për Rregullatorin e Energjisë 03/L-185**

Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 themelon Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) si agjenci të pavarur të Republikës së Kosovës. Ky ligj i përkufizon autorizimet, të drejtat dhe funksionet e ZRRE-së, përfshirë kushtet për krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë elektrike dhe kriteret për rregullimin e ngarkesave.

Paragrafi 3.4 i Nenit 1 – Fushëveprimi, pjesë e Kreut 1 që rregullon Dispozitat e Përgjithshme, kërkon nga ZRRE që të sigurohet që tarifat për veprimtaritë energjetike të rregulluara të jenë të arsyeshme dhe të fiksuara në bazë të një metodologjie të qëndrueshme tarifore, përfshirë edhe sigurimin që ngarkesat e sistemit të shpërndarjes të jenë adekuate për të mundur realizimin e investimeve të domosdoshme në sistem dhe për të lejuar investimet e domosdoshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes.

Neni 42 – Metodologjia tarifore, përshkruan në detaje parimet e ZRRE-së të cilave duhet tu përmbahen metodologjitë tarifore. Kjo metodologji është hartuar në pajtueshmëri me këto parime.

2.5 **Rregulla për vendosjen e çmimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për vendosjen e çmimeve OSSH-së)**

Rregulla për vendosjen e çmimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqesin bazën për përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara (MAR) që mund të fitohen nga Operatori i Shpërndarjes brenda një viti të caktuar, në mënyrë që i njëjti të mund t'i kthejë kostot e arsyeshme të kapitalit, operimit dhe mirëmbajtjes

Neni 16 – Procedura për aprovimin e ngarkesave DUOS, pjesë e Kreut IV mbi Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, kërkon nga OSSH-ja që të përcaktojë ngarkesat DUOS asisoj që: OSSH-ja të mbulojë të ardhurat që nuk kthehen nga ngarkesat tjera dhe që ngarkesat DUOS të jenë në pajtueshmëri me metodologjinë e përpiluar nga OSSH-ja dhe të miratuar nga Rregullatori.

Kapitulli III

3 Vlerat Hyrëse

3.1 Balanca e Energjisë

Në mënyrë që të llogariten kostot e përgjithshme të shpërndarjes, Balanca e energjisë elektrike i sistemit të shpërndarjes duhet të përgatitet duke llogaritur sasinë totale të energjisë në GWh të marrë nga sistemi i shpërndarjes. Ky total është i barabartë me energjinë e marrë nga sistemi i transmisionit plus energjinë e marrë nga gjeneratorët e kyçur në sistemin e shpërndarjes. Energjia totale e marrë duhet të ndahet në:

- Energjinë e dërguar tek konsumatorë të kualifikuar;
- Energjinë e dërguar tek konsumatorët tariforë;
- Humbjet teknike të energjisë në sistemin e shpërndarjes;
- Humbjet jo –teknike (komerciale) të energjisë në sistemin e shpërndarjes

3.2 Periudha Rregullative

Niveli i të hyrave të lejuara maksimale për periudhën e caktuar rregullative i cili do të përcaktohet gjatë shqyrtimeve periodike dhe do të përshtatet brenda çdo viti relevant të jetë në përputhje me Rregullën e Çmimeve të OSSH-së.

3.3 Të hyrat e lejuara maksimale :

Të hyrat që OSSH mund t'i realizojë brenda një viti përcaktohen nga ZRRE si pjesë e procesit 5 vjeçar të shqyrtimit tarifordhe rishikimit vjetor të çmimeve.

Si pjesë e procesit të kontrollit të çmimeve, OSSH i paraqet ZRRE-së parashikimet e detajuara të shpenzimeve, investimet e veta kapitale dhe kthimin e kërkuar për aktivitetet e rregulluara. Kostot që shqyrtohen gjatë këtij procesi kanë të bëjnë me aktivitetet e rregulluara të OSSH-së, d.m.th. aktivitetet si pronar dhe operator i Sistemit të Shpërndarjes. Ky proces nuk përfshin kostot që ndërlidhen me sigurimin e kyçjeve në sistemin e shpërndarjes pasi që ato mbuloohen ndaras me ngarkesat e kyçjes.

Të hyrat e lejuara maksimale duhet të mbulojnë të gjitha kostot e arsyeshme të shkaktuara nga OSSH-ja dhe duhet të jenë në pajtim me formulën e mëposhtme :

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t + KREV_t$$

Ku:

MAR_t Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) ne vitin relevant t

$OPMC_t$ Kostot e lejuara për operim dhe mirëmbajtje ne vitin relevant t

$DEPC_t$ Zhvlerësimi i lejuar ne vitin relevant t

<i>RTNCt</i>	<i>Kthimi i lejuar ne kapital për vitin relevant t</i>
<i>LSSCt</i>	<i>Kostot e lejuara te humbjeve ne vitin relevant t</i>
<i>LICCt</i>	<i>Taksën e Licences ne vitin relevant t</i>
<i>KREVt</i>	<i>Faktori korrektues i te hyrave ne vitin relevant</i>

Kurdo që OSSH-ja ka realizuar të hyra të tjera për kryerjen e ndonjë shërbimi (shërbimet e linjave elektrike, stabilimenteve etj.) ndaj palëve të treta dhe se ato kosto janë rimbursuar nga ato të trajtohen si të hyra të parregulluara në pajtim me shtojcën 4 të Rregullës së Çmimeve dhe do të zbriten nga MAR për të cilin do të ngarkohen konsumatorët e rregulluar.

3.4 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

Kosto e tilla operatori i sistemit të shpërndarjes do të përfshijë në të hyrat e lejuara maksimale dhe do të përshtatë ato duke marr parasysh inflacionin dhe faktorin e efikasitetit gjatë përshtatjeve të rregullta.

3.5 Zhvlerësimi i lejuar

Kostoja e zhvlerësimit do të llogaritet në mënyrë lineare si funksion i Jetëgjatësisë Ekonomike dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara për kategori të ndryshme të konsumatorëve.¹

3.6 Kthimi i lejuar

Kthimi i lejuar mbi koston e kapitalit do të llogaritet si funksion i Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit dhe Bazës së Aseteve të Rregulluara.²

3.7 Kostot e Lejuara të Humbjeve

Kostoja e lejuar e humbjeve do të jetë kostoja e parashikuar e që lidhet me humbjet që duhet të paguhet FPEE-se nga OSSH për të kompensuar humbjet në Sistemin e Shpërndarjes, dhe do të llogaritet duke përdorur Cakun e Humbjeve që caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike.³

3.8 Ngarkesa për Licence

Kostot e përfshira nga OSSH në taksën për licencë duhet të jenë të njëjta me ato që kërkohen nga ZRrE-ja.

¹ Rregulla për Çmimet e OSSH-së

² Rregulla për Çmimet e OSSH-së

³ Rregulla për Çmimet e OSSH-së

Kapitulli IV

4 Alokimi i kostove

4.1 Faktorët e alokimit

Në mënyrë që secilës kategori të konsumatorëve ti pasqyrohen kostot e shërbimit varësishtë prej nivelit të tensionit, operatori i sistemit të shpërndarjes do të alokojë këto kosto (*shprehur në euro*) nëpër nivele të tensionit duke përdorur faktorët përkatës të alokimit (*shprehur në përqindje*).

Të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së alokohen nëpër nivele të tensionit duke marrë parasysh faktorin e alokimit për energji dhe fuqi. Kostot fikse duke përfshirë :

- Zhvlerësimin
- Kthimin
- Pjesën fikse të O&M

alokohen me anë të faktorit të alokimit të fuqisë, ndërsa pjesa tjetër e kostove (duke mos përfshirë kostot e humbjeve) llogariten si kostot totale minus kostot fikse dhe kostot e humbjeve alokohen me anë të faktorit të alokimit të energjisë⁴. Humbjet janë të alokuara në bazë të nivelit të tensionit bazuar në një analizë inxhinierike të humbjeve nëpër nivele të ndryshme të tensionit.

4.1.1 Faktori i alokimit për fuqi

Ky faktorë caktohet duke marr parasysh së pari pesë (5) piket maksimale (brenda intervalit 15 minutash) në gjithë sistemin e shpërndarjes brenda një viti. Piku i secilit konsumatorë në kohën e e pikut të sistemit(piku koïncidues) do të përcaktohet o për konsumatorë të kyçur në nivelin e tensionit 35kV dhe 10kV⁵. Fuqia për konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 0.4 kV do të caktohet si diferencë ndërmjet pikut të sistemit dhe pikut të konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35kV dhe 10kV. Kontributi mesatar vjetorë në pik është përcaktuar për secilin nivel të tensionit si vijon:

$$FAF'_{35kV} = \frac{P_{\max 35kV}}{P_{\max total}}$$

⁴ Për vitin 2012 pjesa fikse e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes është zero, përderisa të mos kemi ndojnë studim.

⁵ Qasja aktuale sipas “Faturimit për Fuqi” do të aplikohet në një periudhë të shkurtër kohore, qasja e dëshiruar është ajo sipas “Pikut Kuïncidues” që do të përdoret në të ardhmen

$$FAF'_{10kV} = \frac{P_{\max 10kV}}{P_{\max total}}$$

$$FAF'_{0.4kV} = \frac{P_{\max 0.4kV}}{P_{\max total}}$$

FAF'-faktori i alokimit për fuqi për nivelin përkatës të tensionit, *shprehur në përqindje*

P_{\max} – fuqia për nivelin përkatës të tensionit, *shprehur në MW*

$P_{\max total}$ – fuqia e përgjithshme (piku i sistemit të OSSH-së), *shprehur në MW*

Pas caktimit të këtyre faktorëve, kostot për fuqi nëpër nivele të tensionit mund të llogariten si më poshtë :

$$K_{35kVf} = FAF'_{35kV} * K_{zhkth}$$

$$K_{10kVf} = FAF'_{10kV} * K_{zhkth}$$

$$K_{0.4kVf} = FAF'_{0.4kV} * K_{zhkth}$$

Ku:

- K_{kVf} kostot për fuqi nëpër nivelet përkatëse të tensionit, *shprehur në euro*

- K_{zhkth} kostot e zhvlerësimit dhe kthimit, *shprehur në euro*

4.1.2 Faktori i alokimit për energji

Alokimi i kostove të energjisë nëpër nivele të tensionit të OSSH-së bëhet duke marrë parasysh konsumin e konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit të mesëm dhe të ultë ndaj konsumit përgjithshëm të energjisë.

$$FAE_{35kV} = \frac{W_{35kV}}{W_{total}}$$

$$FAE_{10kV} = \frac{W_{10kV}}{W_{total}}$$

$$FAE_{0.4kV} = \frac{W_{0.4kV}}{W_{total}}$$

Ku:

FAE'-faktori i alokimit për energji, *shprehur në përqindje*



W_{KV} - konsumi i energjisë në nivelin përkatës të tensionit, *shprehur në MW/h*

W_{total} – konsumi total (i përgjithshëm) i energjisë në nivel të shpërndarjes, *shprehur në MW/h*

Pas caktimit të këtyre faktorëve, kostot energjisë (duke mos përfshirë kostot e humbjeve) nëpër nivele të tensionit mund të llogariten si më poshtë :

$$K_{35kVE} = FAE'35kV * (K_{t1} - K_{zhkth})$$

$$K_{10kVE} = FAE'10kV * (K_{t1} - K_{zhkth})$$

$$K_{0.4kVE} = FAE'0.4kV * (K_{t1} - K_{zhkth})$$

Ku:

K_{kVE} kemi shënuar kostot për energji nëpër nivelet përkatëse të tensionit, *shprehur në euro*

$-K_{t1}$ kostot totale (duke mos përfshirë kostot e humbjeve), *shprehur në euro*

4.2 Kostoja e humbjeve dhe alokimi i tyre

4.2.1 Humbjet teknike

Gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale OSSh-ja do të përfshijë edhe kostot e humbjeve të shkaktuara në nivelin e tensionit të mesëm dhe të ulët për të cilin ai është përgjegjës.

Përshtatjet për nivelin e lejuar të humbjeve ndaj atyre të realizuara OSSh-ja do të bëjë në përputhje me rregullën për çmime të OSSh-së.

Llogaritja e kostove totale të humbjeve është në pajtim me Rregullën për Çmimeve të OSSH-së dhe llogaritet me formulën e më poshtme :

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * WHEA_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

Ku

$LSSC_t$ *Kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant t*

$LSSA_t$ *Humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t*

$REUE_t$ *Njësitë e energjisë (MW/h) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t*

$WHEA_t$ *Mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MW/h) e përcaktuar duke përdorur kostot e lejuara të energjisë me shumicë për FPEE në vitin relevant t*

- LSSCat-1* *Koston e realizuar të humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve)*
- LSSCft-1* *Kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve)*
- It* *Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatgjata mbi normën e EUROBOR-it*
- LSACT-1* *Koston e humbjeve të realizuara gjatë blerjes së energjisë nga FPEE si kompensim të energjisë së humbur në rrjetin e shpërndarjes (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara) në vitin relevant t-1*
- LSSFt* *Faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike*

Alokimi i kosotve të humbjeve nëpër nivele të tensionit bëhet me anë të disa faktorëve të cilët do të quajmë Faktorët për alokimin e humbjeve. Për të gjetur FAH (faktori i alokimit të humbjeve) nevojiten faktorët e alokimit për energji (FAE' dhe FAE'₁) për energji të cilët gjinden ashtu si janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

Niveli i tensionit	Energjia e konsumuar	Faktori i alokimit	Faktori i alokimit për nivelin (10kV+0.4kV)
35kV	W_{35kV}	$FAE_{35kV} = W_{35kV} / W_{total}$	
10kV	W_{10kV}	$FAE_{10kV} = W_{10kV} / W_{total}$	$FAE'_1_{10kV} = W_{10kV} / W_{(10kV+0.4kV)total}$
0.4kV	$W_{0.4kV}$	$FAE_{0.4kV} = W_{0.4kV} / W_{total}$	$FAE'_1_{0.4kV} = W_{0.4kV} / W_{(10kV+0.4kV)total}$
Total	$W_{total} = (W_{35kV} + W_{10kV} + W_{0.4kV})$		$W_{(10kV+0.4kV)total} = (W_{10kV} + W_{0.4kV})$

Ku:

FAE'-faktori i alokimit për energji, *shprehur në përqindje*

FAE'₁-faktori i alokimit për energji (10kV+0.4kV), *shprehur në përqindje*



Sipas analizës të bërë nga OSSh-ja humbjet teknike neper elementet e sistemit paraqiten si në tabelën e mëposhtme.

Humbjet teknike						
	35 kV Linjat	35/10 kV Transformatorët	10 kV Linjat	10/0.4 kV Transformatorët	0.4 kV Sistemi	TOTAL
Total	HI35kV	Htr35/10kV	HI10kV	Htr10/0.4kV	Hsis	Htotal

Ku :

HI-humbjet në linja, *shprehur në MW/h*

Htr-humbjet në transformatorë, *shprehur në MW/h*

Hsis-humbjet e sistemit, *shprehur në MW/h*

Duke shumëzuar faktorët e alokimit për energji (FAE' dhe FAE'₁) me humbjet nëpër elementet e sistemit (transformatorë dhe linja) gjenden humbjet nëpër nivele të tensionit.

Niveli i tensionit	Alokimi i humbjeve					Total	Faktori i alokimit
	35kV Linjat	35/10 Transformatorët	10kV Linjat	10/0.4 Transf.	0.4kV Sis		
35 kV	HI35kV*FAE'35kV					humbjet në 35kV	FAH _{tek35kV}
10 kV	HI35kV*FAE'10kV	Ht35/10kV*FAE' ₁ 10kV	HI10kV*FAE' ₁ 10kV			humbjet në 10kV	FAH _{tek10kV}
0.4 kV	HI35kV*FAE'0.4kV	Ht35/10kV*FAE' ₁ 0.4kV	HI10kV*FAE' ₁ 0.4kV	Ht10/0.4kV	Hsis	humbjet në 0.4kV	FAH _{tek0.4kV}
total humbjet							100,00%

Në tabelën e mësipërme faktori i alokimit të humbjeve teknike është gjendur :

FAH_{tek35kV} =humbjet lidhur me konsumatorët e kyçur në 35kV/total humbjet

FAH_{tek10kV} =humbjet lidhur me konsumatorët e kyçur në 10kV/total humbjet

FAH_{tek0.4kV} =humbjet lidhur me konsumatorët e kyçur në 0.4kV/total humbjet

Ku:

FAH_{tek} – faktori i alokimit të humbjeve teknike, *shprehur në përqindje*

Për ti alokuar kostot e humbjeve teknike duhet që sasia totale e humbjeve teknike (H_{tek}) të shumëzohet me çmimin e blerjes së humbjeve (C_h) dhe faktorin e humbjeve teknike (FAH_{tek}) për nivelin përkatës të tensionit:

$$K_{H_{\text{tek}35\text{kV}}} = H_{\text{tek}} * FAH_{\text{tek}35\text{kV}} * C_h$$

$$K_{H_{\text{tek}10\text{kV}}} = H_{\text{tek}} * FAH_{\text{tek}10\text{kV}} * C_h$$

$$K_{H_{\text{tek}0.4\text{kV}}} = H_{\text{tek}} * FAH_{\text{tek}0.4\text{kV}} * C_h$$

Ku:

$K_{H_{\text{tek}}}$ - kostot e humbjeve teknike nëpër nivelet përkatëse të tensionit, *shprehur në euro*

4.2.2 Humbjet komerciale

Për derisa, humbjet komerciale në bazë të definicionit paraqesin “ Energjinë e pallogaritur “, është e pamundur që ato të maten nëpër nivelet e tensionit. Mënyra më e duhur për ti vlerësuar ato është nga një analizë profesionale. .

OSSH-ja ka siguruar matjen për konsumatorët e tij të kyçur në nivelin e tensionit 35kV dhe 10kV dhe përderisa ata janë konsumatorë të mëdhenj në OSSH, ata monitorohen nga afër. Humbjet komerciale që lidhen me konsumatorët në nivelin e tensionit 35kV dhe 10kV (MWh) do të vlerësohen si % e energjisë së faturuar.

Humbjet komerciale të supozuara (në MWh) në nivelin 0.4kV janë të barabarta me humbjet totale komerciale minus humbjet në 35kV dhe 10kV. Prandaj, këto vlera --(përqindje) do ti përdorim si faktorë për alokimin e humbjeve komerciale (FAH_{kom}).

Llogaritja e humbjeve komerciale nëpër nivele të tensionit llogaritet si humbjet totale minus humbjet teknike:

$$H_{\text{kom}} = H_{\text{totale}} - H_{\text{tek}}$$

Ku:

H_{kom} – humbjet komerciale, *shprehur në MWh*

H_{tek} – humbjet teknike, *shprehur në MWh*

H_{totale} – humbjet totale, *shprehur në MWh*

Për ti alokuar kostot e humbjeve komerciale duhet që energjia e fauruar në nivelin përkatës të tensionit W_{kV} të shumëzohet me faktorin e humbjeve komerciale (FAH_{kom}) për nivelin përkatës të tensionit dhe çmimin e blerjes së humbjeve (C_h):



$$K_{Hkom35kV} = W_{35kV} * FAH_{kom35kV} * C_h$$

$$K_{Hkom10kV} = W_{10kV} * FAH_{kom10kV} * C_h$$

$$K_{Hkom0.4kV} = W_{0.4kV} * FAH_{kom0.4kV} * C_h$$

Ku:

FAH_{kom} - faktori i alokimit të humbjeve komerciale, *shprehur në përqindje*, K_{Hkom} - kostot e humbjeve komerciale nëpër nivelet përkatëse të tensionit, *shprehur në euro*

Kapitulli V

5 Dizajnimi i Ngarkesave

5.1 Parimet

Ngarkesat bazohen nga sasia e energjisë së matur për nivelet përkatëse të tensionit dhe do të shprehet në €/kWh, pra ngarkesat e OSSH-së do caktohen të një-pjesshme, d.m.th nuk do të përmbajnë komponentë të tjerë të faturimit. Kjo është për faktin se shumica e konsumatorëve kanë njehsorë të thjeshtë elektronik (pa matje të fuqisë). Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i ngarkon konsumatorët me ngarkesa varësisht prej nivelit të tensionit në të cilin janë ata të kyçur. Nivelet e tensionit për të cilat OSSH-ja do të caktojë ngarkesat janë :

- 35 kV
- 10 kV
- 0.4 kV

Ngarkesat për kategorinë e ngarkesave gjinden duke mbledhur të gjitha kostot për secilën kategori përkatëse dhe pastaj duke i pjesëtuar me sasinë e energjisë së matur për kategorinë përkatëse (shih ekuacionet):

$$Ngarkesa_{35kV} (\text{€} / kWh) = \frac{\sum \text{kostove } 35kV}{W_{35kV}}$$

$$Ngarkesa_{10kV} (\text{€} / kWh) = \frac{\sum \text{kostove } 10kV}{W_{10kV}}$$

$$Ngarkesa_{0.4kV} (\text{€} / kWh) = \frac{\sum \text{kostove } 0.4kV}{W_{0.4kV}}$$

5.2 Struktura e ngarkesave

Struktura e ngarkesave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ka formën e si në tabelën e mëposhtme :

Grupi i Ngarkesës	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi i ngarkesës	Njësia	Ngarkesat
0	35kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kWh	
1	10kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kWh	
2	0.4kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kWh	



Kapitulli VI

6.1 Procedura për Aprovimin e Ngarkesave të OSSH-së

OSSH-ja do ta dorëzojë për aprovim në Zyrën e Rregullatorit për Energji Metodologjinë e përcaktimit të ngarkesave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe amendamentet pasuese të kësaj metodologjie së paku 30 ditë pune para datës së propozuar për hyrje në fuqi.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mban të drejtën që ta ndryshojë ose modifikojë këtë metodologji sipas nevojës. Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj metodologjie do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

6.2 Dispozitat Përfundimtare

Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes u miratua nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Kjo metodologji është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën angleze dhe serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.